



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO



A.nr.234/2026

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, në përbërje nga: Eshref Shabani-Kryetar, Ardita Haxhnikaj -Demi dhe Malsore Gashi-Bajraktari-anëtarë me Sabile Avdyli, në cilësinë e procesmbajtëses ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr. 234/2026 të datës 03.03.2026 të parashtruar nga ankuesi B.J, kundër organit të punësimit Komuna e Klinës, në çështjen juridike “Kompensim material”, duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1, nenin 16 paragrafi 3 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.2 dhe 1.4 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr.08/L-180, si dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me datë 21.05.2026, mori këtë:

V E N D I M

I. Aprovohet si e bazuar ankesa me numër A.nr. 234/2026 e datës 03.03.2026 e parashtruar nga ankuesi B.J.

II. Obligohet Udhëheqësi i Njesisë se Burimeve Njerëzore në Komunën e Klinës, që brenda afatit prej 15 ditësh nga dita e pranimit të këtij vendimi të bëjë kompensimin e ankuesit nga koeficientit Gj45, 3.92, sipas Akt emërimi me numër protokolli 02. Nr. 112-41494/2024, të datës 11.12.2024 në koeficientin 5.4.

III. Detyrohet Drejtori i Thesarit të Kosovës që të ndërmarr veprime për ekzekutimin e pagesës pas pranimit të kërkesës si në piken II të dispozitivit.

IV. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, duhet të njoftohet me shkrim pas ndërmarrjes së veprimeve në pajtim me këtë vendim.

A r s y e t i m

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, përmes vendimit A. Nr. 489/2025, të datës 30.04.2025, ka aprovuar ankesën A. Nr.489/2025, të datës 18.03.2025, të ankuesit B.J, si të bazuar në ligj, duke e detyruar Njësinë e Burimeve Njerëzore të Komunës së Klinës që brenda afatit prej 15 ditësh nga dita e pranimit të këtij vendimi, të ndërmarrë veprimet për klasifikimin e vendeve të punës për ankuesin, në pajtueshmëri me dispozitat ligjore në fuqi.

Me qëllim të zbatimit të vendimit A. Nr. 489/2025, të datës 30.04.2025, të Këshillit Kryetari i Komisionit të Ristrukturimit të Komunës së Klinës, i propozon Njësisë për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore të pezullon procedurën e ristrukturimit për nëpunësin civil B.J i sistemuar në pozitën Zyrtar i gjendjes civile në Drejtorin për Administratë -Sektori i gjendjes civile deri pas përfundimit të periudhës provuese sipas Akt Emërimit me Nr.02-112-41494/2024 të datës 11.12.2024

Po ashtu Menaxheri i Burimeve Njerëzore i Komunës së Klinës, duke u bazuar në vendimit A. Nr.489/2025, të Këshillit, përmes njoftimit të datës 12.05.2025 kanë njoftuar Këshillin për pezullimin e procedurës së ristrukturimit deri pas përfundimit të periudhës provuese.

Ankuesi B.J, me datën 03.03.2026, , përmes emailit ankesa.kpmschck@rks-gov.net ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me pretendimet ankimore lidhur me moszbatimin e vendimit A.nr.489/2025 të Këshillit me të cilin ka detyruar Njësinë e Burimeve Njerëzore të Komunës së Klinës që brenda afatit prej 15 ditësh nga dita e pranimit të këtij vendimi, të ndërmarrë veprimet për klasifikimin e vendeve të punës për ankuesin, në pajtueshmëri me dispozitat ligjore në fuqi. Ankuesi periudhën provuese e ka kaluar dhe ende nuk i është ndryshuar Akt Emërimi nga klasa Profesional 3 në Profesional 2 bazuar në Katalogun e Vendeve të Punës për Shërbimin Civil i datës 23.10.2024 dhe kërkon që Njësia e Burimeve Njerëzore në komunën e Klinës ti ndërmerr të gjitha veprimet e nevojshme për klasifikimin e vendit të punës në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, ka administruar këto prova: Ankesën me numër protokollit 1093/2026 të datës 03.03.2026 të parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Kopje e letërnjoftimit për ankuesin; Vendimi A. Nr. 489/2025, i datës 30.04.2025, i Këshillit; Propozimi i datës 12.05.2025 për pezullimin e procedurës së ristrukturimit; Akt Emërimi me Nr.02-112-41494/2024 të datës 11.12.2024; përshkrimi i detyrave të

Punës; Konkursi me nr. reference RN00014990 i datës 03.09.2024; Emal i datës 12.05.2025; Fletë dërgesë e datës 12.05.2025; Procesverbali i datës 12.05.2025.

Kolegji i Këshillit pas shqyrtimit dhe analizimit të shkresave të lëndës të parashtruara nga palët në procedurë, konstatoi se ankesa e ankuesit , është e bazuar, sepse:

Nga provat e administruara rrjedhë së ankuesi sipas Akt Emërimit me Nr.02-112-41494/2024 të datës 11.12.2024.është i punësuar në pozitën Zyrtar i gjendjes civile në Drejtorin për Administratë -Sektori i gjendjes civile në Komunën e Klinës, klasa Profesional 3 me koeficient GJ45-3.92.

Me tej Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, përmes vendimit A. Nr. 489/2025, të datës 30.04.2025, ka aprovuar ankesën e datës 18.03.2025, të ankuesit B.J, si të bazuar në ligj, duke e obliguar Njësinë e Burimeve Njerëzore të Komunës së Klinës që brenda afatit prej 15 ditësh nga dita e pranimit të këtij vendimi, të ndërmarrë veprimet për klasifikimin e pozitës së ankuesit në pajtim me Rregulloren për Klasifikimin e Vendeve të Punës në Shërbimin Civil, dhe Katalogun e Vendeve të Punës për Shërbimin Civil.

Me qëllim të zbatimit të vendimit A. Nr. 489/2025, të datës 30.04.2025, të Këshillit, Kryetari i Komisionit të Ristrukturimit të Komunës së Klinës, propozon tek Njësia e Burimeve Njerëzore e Komunës së Klinës, që të pezullohet procedura e ristrukturimit deri në përfundimin e periudhës provuese.

Po ashtu Menaxheri i Burimeve Njerëzore i Komunës së Klinës, duke u bazuar në vendimit A. Nr.487/2025, të Këshillit, përmes vendimit me numër protokolli 01. Nr. 112-16114, të datës 02.06.2025 për shkak të se ankuesit nuk i ka përfunduar periudha provuese duhet të pezullohet procedura e ristrukturimit në Komunën e Klinës për pozitën Zyrtare për Gjendje Civile 2, në kategorinë profesional 2, klasa e pagës 5.4.

Me tej Menaxheri i Burimeve Njerëzore i Komunës së Klinës, me datë 11.12.2024, ka lëshuar Akt Emërimit me numër protokolli 02. Nr. 112-41494/2024, ku ankuesi është caktuar në pozitën Zyrtare për Gjendje Civile në Klinë, në kategorinë profesional 3, klasa e pagës 3.92.

Ankuesi B.J, me datën 03.03.2025, ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me pretendimet ankimore që Zyra e Personelit në Komunën e Klinës të bëjë klasifikimin e pozitës sime nga profesional 3 në profesional 2 , sipas Katalogut të vendeve të punës për Shërbimin Civil.

Në kuptim të themelësisë dhe bazueshmerisë së pretendimeve ankimore, Kolegji ju referua dispozitave të Ligjit Nr.08/L-196 për Pagat në Sektorin Publik, i zbatueshëm nga data 05.02.2023, përkatësisht nenit 2, paragrafi 1, në lidhje me fushëveprimin ku parashihet se: *''1. Ky ligj zbatohet për të punësuarat/it në sektorin publik pagat e të cilave/ëve financohen nga dhe përmes buxhetit të shtetit,.. 2. Rregullat dhe kushtet për përcaktimin e pagës të të punësuarave/ve në sektorin publik janë ekskluzivisht rregullim i këtij ligji dhe mund të rregullohen edhe me akte të tjera nënligjore, vetëm kur parashihet shprehimisht nga ky ligj''*, dhe nenin 14, paragrafi 3, të këtij ligji ku përcaktohet se: *3. Klasifikimi i një pozite të caktuar të shërbimit civil, bëhet në bazë të rregullave të vlerësimit dhe klasifikimit të pozitave të punës, sipas dispozitave për klasifikimin e pozitave të shërbimit civil, në pajtim me legjislacionin në fuqi për zyrtarët publik, dhe rrjedhimisht, referuar këtij përcaktimi ligjor, Kolegji i Këshillit konstaton së paga bazë e nëpunësit civil përcaktohet sipas klasës së pagës, përkatësisht koeficientit, të cilit i përket pozita e punës, e klasifikuar në shtojcat e Ligjit Nr.08/L-196 për Pagat në Sektorin Publik, ndërsa klasifikimi i një pozite të caktuar të shërbimit civil, bëhet në pajtim me legjislacionin në fuqi për zyrtarët publik dhe rregulloren e aplikueshme për klasifikimin e vendeve të punës në Shërbimin Civil.*

Në kontekst të konstatimit si më sipër, Rregullorja (QRK) Nr. 06/2024 për Klasifikimin e Vendeve të Punës në Shërbimin Civil, përcakton:

- **Neni 22, 1.** *Çdo vend pune në shërbimin civil, është pjesë e një prej klasave në shërbimit civil të përcaktuara sipas kësaj Rregullore. 2. Çdo pozitë konkrete e kategorisë profesionale, klasifikohet si pjesë e një prej tri (3) klasave të kategorisë përkatëse. 3. Klasifikimi i një pozite në kategorinë e profesionale apo të specialistëve bëhet në bazë të procesit të vlerësimit dhe klasifikimit të punës në pajtim nenet 21-26 kësaj Rregulloreje.*

- **Neni 23:** *1. Klasifikimi i një vendi të punës të kategorisë së specialistëve dhe profesionale si pjesë e një prej klasave të parashikuara në nenin 14 dhe 15 të kësaj Rregullore, bëhet nëpërmjet analizës dhe vlerësimit të nivelit të faktorëve të klasifikimit dhe të kriteret e përgjithshme të kërkuara. 12 2. Analiza e faktorëve të klasifikimit bëhet për çdo faktor mbështetur në përshkrimin e vendit përkatës të punës. 3. Karakteristikat që paraqet pozita konkrete sipas secilit faktor, krahasohen me karakteristikat e faktorëve*

të klasifikimit të përcaktuar për çdo klasë në pajtim me Shtojcën Nr. 1 të kësaj Rregulloreje. 4. Pozita vlerësohet e klasifikuar në atë klasë me karakteristikat sipas faktorëve të cilës ka më shumë ngjashmëri.

- **Nenit 24:** Vlerësimi për klasifikimin e pozitave të punës të kategorisë të specialistëve dhe kategorisë profesionale, bëhet nga Grupi i Vlerësimit, çdo herë që përgatitet një Rregullore e organizimit të brendshëm të institucionit.

- **Nenit 27:** 1. Klasa të cilës i përket secila pozitë konkrete e kategorisë së specialistëve dhe profesionale, përcaktohet dhe miratohet njëkohësisht me Rregulloren për Organizim të Brendshëm të Institucionit. 2. Miratimi përfundimtar i klasifikimit të vendeve të punës ndjek procedurën për propozimin dhe miratimin e Rregullores së Organizimit të Brendshëm në pajtim me dispozitat ligjore në fuqi.

-**Nenit 33,** i cili përcakton: Një nëpunës civil i cili aktualisht është i vendosur në një klasë të kategorisë profesionale dhe nuk posedon nivelin dhe llojin e arsimimit të përcaktuar për atë klasë, sipas kësaj Rregulloreje, vazhdon të mbaj pozitën nëse së paku tri vitet e fundit ka vlerësim pozitiv të rezultateve në punë.

Në kuptim të bazës ligjore si më sipër dhe në ndërlidhje më pretendimet e ankuesit Kolegji thekson faktin e pakontestueshëm së sipas Katalogut të Vendeve të Punës në Shërbimin Civil pozita Zyrtar i Gjendjes Civile është përcaktuar më Kodin SHC-1118, klasa Profesional, 2 Grupi i shkencave shoqërore (Juridik, Ekonomik (pa specifikim), Sociologji, Antropologji, Filozofi, Histori), ndërsa, referuar Shtojcës Nr. 1/6 të Rregullores (QRK) Nr. 06/2024 për Klasifikimin e Vendeve të Punës në Shërbimin Civil, si kriteret të përgjithshme formale për klasën profesional 2 janë përcaktuar diplomë e arsimit të lartë e nivelit të parë (Bachelor), diplomë e nivelit të pestë të KKK, për fushën e TIK, kështu që, nisur nga ky përcaktim ligjor rrjedhë së pretendimet ankimore të ankuesit për klasifikim të pozitës së tij në klasën profesional 2 janë të bazuara, mbi arsyet se ankuesi ka diplomë të shkollimit të lartë, respektivisht i njëjti ka të përfunduara studimet themelore universitare (studime të nivelit të parë-bachelor)

Po ashtu, Kolegji për trajtim të drejtë kësaj çështje administrative mori parasysh edhe përcaktimet ligjore sipas nenit 33 të Rregullores (QRK) Nr. 06/2024 për Klasifikimin e Vendeve të Punës në Shërbimin Civil, ku parashihet se: Një nëpunës civil i cili aktualisht është i vendosur në një klasë të kategorisë profesionale dhe nuk posedon nivelin dhe llojin e arsimimit të përcaktuar për atë klasë, sipas kësaj Rregulloreje, vazhdon të mbaj pozitën nëse së paku tri vitet e fundit ka vlerësim pozitiv të rezultateve në punë..” dispozita këto që nuk gjejnë aplikim në rastin e ankuesit sepse përkundër që ankuesi ka ushtruar

pozitën e zyrtarit të gjendjes civile më shumë së tri vite dhe ka vlerësime pozitive në tri vitet e fundit, i njëjti nuk ka arsim universitar siç kërkohet për pozitën në fjalë.

Si rrjedhojë, Kolegji i Këshillit ka analizuar edhe dëshmitë për përgatitjen profesionale për ankuesin dhe nga shkresat e lëndës konstaton se ankuesi posedon Diplomë me numër protokolli 1588/2020, të datës 05.10.2020, të lëshuar nga Kolegji AAB, me çka dëshmohet se ka përfunduar studimet dhe fitoi gradën L.L.B në Juridik/Specializimi Juridik i Përgjithshëm, andaj Kolegji i Këshillit pasi ka analizuar përgatitjen profesionale të ankuesit ka konstatuar se pretendimi ankimore i ankuesit është i bazuar në ligj.

Andaj, mbi arsyet si më lartë, Kolegji vlerëson se Propozimi 02 Nr.112-14005/2025 i datës 12.05.2025, i Komisionit të Ristrukturimit të Komunës së Klinës lidhur me klasifikimin e pozitës së ankuesit për pezullimin e procedurës së ristrukturimit deri në përfundimin e periudhës provuese është vendim i drejtë dhe i nxjerr në pajtim të plotë më të drejtën materiale. Rrjedhimisht, në kuptim të nenit 18, paragrafi 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, si dhe nenit 132 ,paragrafi 2 të Ligjit Nr.L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, Kolegji refuzoj ankesën si të pabazuar duke lënë në fuqi si të ligjshëm Propozimin 02Nr.120-14767/2025, të datës 19.05.2025, të Komisionit të Ristrukturimit të Komunës së Klinës.

Këshillë Juridike: Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit. Pala e pakënaqur, e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm, mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Administrative në Prishtinë/Departamenti për Konteste në Punë, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh, nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS

Lënda me numër A.nr.234/2026

Sabile Avdyli

Eshref Shabani

Procesmbajtëse

Kryetar i Kolegjit

Vendimi i dorëzohet:

- Ankuesit B.J;
- Njesisë së Burimeve Njerëzore në Komunën e Klinës; dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.